




Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj , Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së	
Nga:	Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 12.05.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini , Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj , Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	Nr.020- 378/3
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Vendimin Nr. 12 - 400/01-17674** për lirimin nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financu / Ministry of Finance
Aktiva - Arhiva - Archive

Numri i Urdhrit / Ord. No. / Ord. No. 024494/01
Nr. i Tërësive / Total / Total 740-1/2021
Brez i Nivelo / No. pages 11, 05.2021
PRISTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - 14.05.2021
Ministry of Finance, Labour and Transfers

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration
Ministry of Local Government Administration
Rada i Trasfera - 14.05.2021

Numri i Urdhrit / Ord. No. / Ord. No.	Shifra / Digit / Digit	Vlera / Value / Value
-VI-	012-378/3	

Për:	Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
	Trim Berisha, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Kopje:	Kryetari i Komunës së Drenasit
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Hekuran Murati, Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve
	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Klit Shala, Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Elmedina Bajgora, Zyrtare e Lartë Ligjore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Engjëllusha Januzi, Zyrtare e Lartë për Mbikëqyrjen e Kontrollit të Ndihmës Shtetërore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së akteve të komunave
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Ministër z. Krasniqi,

I nderuari Sekretar i Përgjithshëm z. Berisha,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<i>Vendimi Nr. 12-400/01-17674 për lirin nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021</i>
<i>I miratuar më datë 28.04.2021</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.04.2021</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 30.04.2021</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore bazuar në këndvështrimet e mëposhtme:

- Fillimisht, Neni 8 i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (këtej e tutje “Ligji”) i përcakton taksat komunale dhe qiratë në pronat e paluajtshme si kategori e të hyrave vetanake të komunës.

Në këtë drejtim, neni 10 dhe neni 11 i Ligjit e njeh, ndër tjerash, taksën për lejen në ushtrimin e veprimtarisë afariste, si dhe taksën për lejen për shërbime profesionale – të cilat mbesin në diskrecion të komunave për përcaktim. Ngjashëm me këtë, neni 20 i Ligjit i jep të drejtë komunës të vendosë dhe rrjedhimisht, të mbledhë qiratë e shfrytëzimit të pronës komunale – si të hyra nga qiradhënia.

Andaj, meqenëse të hyrat në rastin konkret konsiderohen burime financiare komunale, komuna disponon lirshëm me to dhe ka pavarësi financiare gjatë ushtrimit të kompetencave të saj komunale – konform nenit 2 të Ligjit.

- E potencuar edhe me konstatimin e komisionit të komunës së Drenasit (bashkëngjitur në dokumentacionin përcjellës), masa e vendimit të komunës ndikon në reduktimin e të ardhurave të komunës.

Si rezultat, akti administrativ që është subjekt i shqyrtimit i plotëson kriteret për t’iu nënshtruar rregullave të ndihmës shtetërore, të përcaktuara me Ligjin Nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore (këtej e tutje “LNSH”), marrë për bazë se ky i fundit potencon që ndihmë shtetërore konsiderohet edhe çdo reduktim i të ardhurave të shtetit. Rrjedhimisht, masa e përcaktuar me vendimin e komunës duhet të analizohet konform dispozitave të përcaktuara në LNSH.

Pasi që në aktin komunal nuk është theksuar vlera e ndihmës së dhënë apo vlera e përfitimit nga secili biznes, dhënësi i ndihmës – pas konstatimit të vlerës së ndihmës, duhet të respektojë:

- Nenin 7: Ndihma “De Minimis” të LNSH, nëse kemi të bëjmë me përfitime në vlerë deri në 200,000 EUR (për 3 vite fiskale), dhe kështu sipas Nenit 18 të Rregullores


(QRK) Nr. 04/2020 për Ndhimën “De Minimis”, institucioni dhënës obligohet që brenda 15 ditësh pas dhënies së ndihmës të raportojë nëpërmjet formularit të njoftimit konform Shtojcës 1 dhe 2 të Rregullores në Departamentin e Ndhmës Shtetërore; ose

- **Nenin 11: Njoftimi për ndihmë shtetërore të LNSH, për vlera tjera dhe kështu sipas Rregullores (QRK) Nr. 19/2018 për Procedurat dhe Format e Njoftimit për Ndhimën Shtetërore**, institucioni dhënës obligohet që të bëjë njoftimin e ndihmës në Departamentin e Ndhmës Shtetërore, duke plotësuar formularët e njoftimit (pjesë shoqëruese e kësaj Rregullore), me kushtin që ndihma e njoftuar nuk krijon efekt para autorizimit nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, akti komunal i komunës së Drenasit nuk është në kundërshtim me dispozitat në fuqi – me kusht që sqarimet e theksuara në këtë shkresë të merren parasysh nga komuna gjatë procedimit të mëtutjeshëm.

Ministria mbetet në dispozicion të komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve
Kopje:	Kryetari i Komunës së Glllogocit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Irim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtarët përgjegjës:	30.04.2021 Nr.020-378
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 12 - 400/01-17674 për lirimin nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, për lirimin nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021

I miratuar më datë: 28.04.2021

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.04.2021

2025

Date

Am fost la domiciliu al lui 15 din 1991 la domiciliul din ...
 ...

...
 ...
 ...
 ...
 ...

...
 ...
 ...
 ...
 ...

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit

01 Nr. 442/03-17330 dt. 26.04.2021

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores Nr.12-400-16581, të datës 27.05.2020 për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjyba, nenit 2, 10, 11 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, me ndryshimet e tij sipas ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shpalljes së virusit COVID-19, si pandemi, Rekomandimit Nr.01-020/04-16642, të datës 23.04.2021, të komisionit për dhënie të rekomandimit lidhur me mundësinë e heqjes së taksës së operimit dhe shfrytëzimit të hapësirave publike (Gastronomisë) për vitin 2021, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2021, të aprovoj këtë:

POPOZIM VENDIM

Për lirim nga taksa e operimit të bizneseve dhe lirim nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021

Neni 1

Me këtë propozim vendim, lërkohet lirim nga taksa e operimit për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit dhe lirim nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.

Neni 2

Bizneset e liruar nga taksa e operimit për vitin fiskal 2021 janë të përcaktuara/përfshira në nenin 13 të Rregullores Nr.12-400-16581, të datës 27.05.2020, ndërsa për lirim nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike të bizneseve të gastronomisë sipas listës së Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimin të ligjshmërisë nga ana e MAPI-së.



ARSYETIM

Duke pasur parasysh situatën e krijuar pas shfaqjes së virusit COVID-19, vështirësive të cilat po ballafaqohen bizneset, Rekomandimit Nr.01-020/04-16642, të datës 23.04.2021, të komisionit për dhënie të rekomandimit lidhur me mundësinë e heqjes së taksës së operimit dhe shfrytëzimit të hapësirave publike (Gastronomisë) për vitin 2021, kërkohet lirimi nga taksa e operimit për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit dhe lirimit nga qiraja e shfrytëzimit të hapësirave publike për bizneset e gastronomisë për vitin 2021.

E gjithë kjo duke pasur parasysh vështirësitë financiare të bizneseve për të ushtruar veprimtarinë e tyre ekonomike në këtë gjendje të pandemisë.

Bashkëngjitur gjeni rekomandimin e komisionit Nr.0-020/04-16642, të datës 23.04.2021.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Data: 23.04.2021			
Nr. 12	Numer	Shtojca	Vlera



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit



Data: 23.04.2021

Për: Kryetarin e komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovi

Nga: Komisioni i formuar me vendim të datës 21.04/2021, me nr. protokoli 020/04-16642

Lëndat: Rekomandim për lirin nga taksa e operimit për bizneset në Komunën e Drenasit dhe shfrytëzimin të hapësirave publike (gastronomisë)

Kriza Emergjente Shëndetësore e shkaktuar nga pandemia Covid-19 ka ndikuar jo vetëm në aspektin shëndetësor, por edhe ekonominë e brishtë të Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës për të ruajtur shëndetin e qytetarëve ndërmori disa masa, si kufizimi i lëvizjes së qytetarëve, kufizimi i shërbimeve dhe mallrave, udhëtimet, të cilat kanë ndikuar në aktivitetin biznesor në të gjithë sektorët pa dallim dhe kanë detyruar bizneset që të zvogëlojnë ushtrimin veprimtarisë së bashkë me këtë edhe numrin e të punësuarve. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, Bankës Botërore dhe institucioneve tjera vendore, bruto produkti vendor në Kosovë ka rënë - 8.8% që për ekonominë kosovare është një rënie e madhe e cila po vazhdon edhe në këtë katërmujor të vitit 2021.

Përveç ndihmës nga pakë emergjente fiskale nga Qeveria, Komuna e Drenasit nuk ka arritur të subvencionoj me mjete financiare bizneset për shkak se nuk lejojnë masat buxhetore, por ka mbështetur disa biznese të vogla e start-up biznese përmes grant-ve të cilat janë ndarë me organizatat që kemi bashkëpunim.

Nga vizitat në terren dhe takimet me bizneset, kanë deklaruar se e kanë të vështirë ushtrimin e veprimtarive të tyre si pasojë e humbjeve që kanë pësuar nga kriza emergjente e shkaktuar nga Covid-19. Ndërsa, kanë theksuar se lirin nga taksa komunale e operimit për vitin e kaluar, ka ndihmuar që barra e pasojave të pandemisë të jetë më e lehtë.

Pasojat e vitit të kaluar vazhdojnë të jenë edhe në këtë vit të pandemisë, ku eksportet e shërbimeve dhe investimet do të marrin edhe kohë për t'u rimëkëmbur. Shuarja e 23 bizneseve në vitin e kaluar dhe 9 të tjera në këtë vit në komunën tonë, konsiderojmë se pandemia është një nga faktor kyç që ka ndikuar në shuarjen e tyre. Ndërsa, nëse zgjatë pandemia dhe masat kufizuese, kjo mund të prodhojë pasojë edhe më të thella për bizneset, konsumin privat, por edhe për eksportet dhe remitencat nga diaspora.

Zingjiri i këtyre problemeve në aspektin ekonomik, siguron se ndikon në rënten e të hyrave që inkasojmë nga taksat vjetore të bizneseve. Mirëpo, mungesa e këtyre të hyrave prej taksave për këtë vit, për dallim nga bizneset, nuk prodhon pasoja apo dëme të cilat nuk rimëkëmben, pasi mund të mbulohen prej të hyrave indirekte apo nga palët e treta. Pra, vlerësojmë që mungesa e tyre edhe këtë vit nuk ka pasoja afatgjate dhe të mëdha. Përkundrazi, pasojat afatgjate dhe më të mëdha do të vërehen nëse nuk lu dalim në ndihmë bizneseve tona.

Prandaj, duke u bazuar në vendimin e datës 21.02.2021, me numër protokoll 0200 04-16642, ku kërkohet dhënia e rekomandimeve lidhur me taksën e operimit për vitin 2021 për të gjitha bizneset që ushtrojnë veprimtari në Komunën e Drenasit dhe shfrytëzimit të hapësirave publike (gastronomia) dhe duke u bazuar në komentet me lartë, si komision vlerësojmë dhe rekomandojmë se bizneset duhet të lirohen nga taksa komunale e operimit për këtë vit dhe shfrytëzimit të hapësirave publike (gastronomia)

Ky rekomandim është bazuar në faktet se lirimi nga taksa e operimit për vitin 2021 lehtëson ushtrimin e veprimtarive biznesore në Komunën e Drenasit, stimulon apo naixte për riutje të aktivitetëve biznesore si dhe është në përputhje me praktikën e mbështetjes së bizneseve të dëmtuara nga kriza pandemike.

Ekonomia e vendit nuk është si para pandemisë dhe ne duhet të përshtasim politikat tona në përputhje me gjendjen aktuale dhe në të njëjtën kohë të jemi të gatshëm për tu përshtatur me çdo rrethanë të re që mund të krijohet nga pandemia.

Anëtarët e komisionit:

1. Shyqiri Bublaku (kryetar)
2. Laureta Thaqi (anëtarë)
3. Anila Avdullahu (anëtarë)
4. Shqipë Zogu (anëtarë)
5. Kimete Qorri (anëtarë)

